



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 769 / Prot. 9

Divjakë, më: 13.02.2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. 10, DATË 13 / 02 / 2024

PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, NË BASHKINË DIVJAKË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB nr.67, datë 26.12.2023 “Për Miratimin e Buxhetit, Numrit Maksimal të Punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet Vartëse të Bashkisë Për Vitin 2024”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë,

1. Të miratojë 10 (dhjetë) punonjës mirëmbajtje së rrjetit ujitës dhe faturues uji sezonalë me kontratë të përkohshme, pranë Bashkisë Divjakë, me kontratë 6-mujore, nga periudha 15.03.2024 deri më 15.09.2024 sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij projekt-vendimi.
2. Të miratojë 2 (dy) punonjës sezonalë turni II, (kullat,varkat) me kontratë të përkohshme 4-muaj, nga periudha 01.06.2024 deri më 30.09.2024.
3. Të miratojë 3 (tre) punonjës mirëmbajtje dhe pastrimi me kontratë të përkohshme 3-mujore, nga periudha 01.06.2024-31.08.2024.
4. Të miratojë 6 (gjashtë) punonjës sezonalë në Agjencinë e Shërbimeve Komunale me kontratë të përkohshme, 3-mujore nga periudha 01.06.2024 deri më 31.08.2024.
5. Shpenzimet për paga (600) dhe sigurime shoqërore (601) do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Divjakë. Fondet janë planifikuar në fillim të vitit kalendarik.

Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

Eneida Davidhi

Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike

Andi Bullari

Përgj. Z. Financës

Xhuljan Mullaj

KRYETARI

Josif Gorrea



Lidhja nr. 1

Punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2024 pranë Bashkisë Divjakë, Drejtorisë së Infrastrukturës, Sektori Ujitje-Kullim dhe Agjencisë së Shërbimeve Komunale.



Nr.	Institucioni	Emërtimi i pozicionit	Nr.i punonjësve	Orari i punës	Kohëzgjatja e kontratës	Paga bruto/lekë
1.	Bashkia Divjakë	Punëtor mirëmbajtje së rrjetit ujitës dhe faturues uji	10	8 orë	15.03.2024-15.09.2024	40 000
2.	Bashkia Divjakë	Sportelist Kulla dhe Varkat, turni II-të	2	8 orë	01.06.2024-30.09.2024	40 000
3.	Bashkia Divjakë	Punonjës mirëmbajtjeje dhe pastrimi	3	8 orë	01.06.2024-31.08.2024	40 000
4.	Agjencia e Shërbimeve Komunale	Punëtor pastrimi	6	8 orë	01.06.2024-31.08.2024	40 000

Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

Eneida Davidhi

Përgjegjës sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike

Andi Bullari

Përgjegjës i Sektorit të Financës

Khuljan Mullaj

KRYETARI

Josif Gorrea